

NGJITËSIT E PLLAKAVE



S-FLEX C2TES1

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
E bardhë, Gri	25 KG	3-5 KG

PËRSHKRIM

Ngjitës për pllaka me bazë çimento (C), me forcë ngjitëse të përmirësuar (2), parrëshkitshmëri vertikale (T), kohë e gjatë punueshmërie (E) dhe me fleksibilitet (S1). I klasifikuar si ngjitës C2TES1 sipas standartit EN 12004.

FUSHA E APLIKIMIT

S-Flex I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të qeramikës, gresit, porcelanit, mermerit, pllakave të gurit, mozaikëve, tullave të xhamit. I rekomandueshëm për fasada, tar-raca, për ambiente me ngrohje qendrore, për ambiente me sipërfaqe të vështira, pishina etj. I përshtatshëm për përdorim në suporte me bazë çimento si beton, çimento, suva, veshje hidroizoluese etj. I përshtatshëm për ngjitjen e pllakave të formatit 5-150 cm.


SPECIFIKIME

Karakterizohet:

- Punueshmëri shumë e mirë.
- Bardhësi e theksuar.
- I përshtatshëm për aplikime të brendshme dhe të jashtme.
- Për pllaka me dimensione deri në 150cm.
- I përshtatshëm për të gjitha llojet e pllakave & sipërfaqeve ku ka vështirësi si: Prani lagështie, vibrime, fasada, etj.

MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vajra dhe jo të pista dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Përafërsisht dyshemetë tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale duhet të kenë një kohë stazhionimi të paktën 28 ditë, bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhen të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike. Përpara aplikimit të produktit, sipërfaqja e suportit duhet të spërkatet me ujë në mënyrë që produkti të krijojë një ngjitje sa më të mirë dhe të ketë një kohë punueshmërie sa më optimale.






APLIKIMI

Fillimisht produkti rekomandohet të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës për të pasur një shpërndarje sa më të njëtrajtshme dhe më pas me pjesën e dhëmbëzuar. Aplikimi bëhet me një mallë të përshtatshme në varësi të llojit të pllakës që shtrohet. Vendosja e pllakave bëhet duke ushtruar një presion të vogël mbi pllakë duke u siguruar që pllaka të mbulohet në të gjithë sipërfaqjen me kollë. Koha e hapjes së produktit në kushte atmosferike normale është 35 minuta për temperatura 23°C. Kushtet atmosferike mund të ndikojnë në kohën e tharjes së produktit. Duhet pasur kujdes që kolla nuk duhet të formojë sipërfaqje filmi. Në të kundërtatëherë është e nevojshme që të kalohet dhe një herë malla mbi kollë. Nuk këshillohet që pllakat të vendosen me fuga të puthitura. Pllakat vendosen në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme me dimensionet e tyre.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Koha e korigjimit: 35 min
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg	Mbushja e fugave në mure: Pas 8 deri 12 orësh
Ngjyra: E bardhë, Gri	Mbushja e fugave në dysHEME: Pas 24 orësh
Konsumi për formate të vogla: 2-3 kg/m ²	I shkëlshëm: Pas 24 orësh
Konsumi për formate të mëdha: 4-5 kg/m ²	Forca ngjitesë pas 28 ditësh: ≥1 N/mm ²
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	FN pas zhytjes në ujë: ≥1 N/mm ²
Koha e Magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	FN pas reaksionit nga ngrohja: ≥1 N/mm ²
Masa Vëllimore: 1.6-1.7gr/cm ³	FN pas cikleve ngrirje-shkrirje: ≥1 N/mm ²
Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa A1	FN pas 30 min: ≥0,5 N/mm ²
Ujë për përzierje: 6 litra ujë për 25 kg	Rrëshkitshmëria: ≤0,5 mm
pH i përzierjes: 13	Deformueshmëria: ≥S1
Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C	



Kujdes! Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund të ndryshojnë karakteristikat e punimit të produktit (ngadalsim ose përshpejtim në tharje të produktit). Për formate pllakash shumë të mëdha, aplikimi shtrim të dyfishtë të kollës në pllakë dhe bazament. Mbroni bazamentin për të paktën 24 orë pas aplikimit të ngjitesit, nga shirat e rrëmbyer si dhe nga ngricat dhe rrezet e forta të diellit. Për formate të mëdha pllakash vendosja e fugës do të bëhet 3-5 ditë pas ngjitjes vetëm nëse është bërë hidroizolimi.